



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5080/Prot.
13

Pogradec, më 27.12.2024

VENDIM

NR. 143, DATË 27.12.2024

PËR

PËRCAKTIMIN E DESTINACIONIT TË PËRDORIMIT, TË SIPËRFAQES TRUALL TË SHPRONËSUAR NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM RRUGËSH BLOKU TE STADIUMI", POGRADEC.

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", shkronjës "a" të pikës 1.2 të nenit 9, shkronjave "e", "k" dhe "n" të nenit 54, shkronjës "c" të nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", pikat 1 shkronjat "e", "f", pika 8 shkronja "a", pika 9, të nenit 7, të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Kreun VI, neni 801 e vijues të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 300, datë 11.5.2022, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Sistemim rrugësh, blloku te Stadiumi", Pogradec, pikat 1 dhe 2 të Kreut I, pika 1 shkronja "ç" e Kreut II, pika 2 e Kreut III, Aneksi C, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitheoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të

Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 111, datë 21.10.2022 "Për themelimin e shoqërisë "Pogradeci Invest Shpk" dhe miratimin e aktit te themelimit dhe statutit", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të përcaktojë destinacionin e përdorimit, të sipërfaqes truall të shpronësuar nga zbatimi i projektit "Sistemim rrugësh blloku te Stadiumi", Pogradec, duke miratuar rregulla dhe kriterë, të detajuara si më poshtë vijon:
 - 1.1 Nga sipërfaqja totale e truallit 233.7 m2, të përdorej për parkim me pagesë sipërfaqja 133.7 m2 dhe sipërfaqja e mbetur prej 100 m2, të përdorej parkim për rezidentët ose për subjektet tregtare.
 - 1.2 Administrimi i truallit me sipërfaqe 133.7 m2, i destinuar për parkim me pagesë do të administrohet nga, POGRADECI INVEST SHPK, e cila është shoqëri në pronësi dhe pronar të vetëm Bashkia Pogradec.
 - 1.3 Sipërfaqja truall 100 m2, e destinuar që të përdorej parkim për rezidentët ose për subjektet tregtare, të jepej me qira ose me enfiteozë, me procedurë konkurrim të hapur, në përputhje me dispozitat e Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", të ndryshuar.
 - 1.3.1 Tarifa dysheme e qirasë mujore me të cilën do të fillojë procedura e konkurimit të jetë 20 lek/m2, sipas Aneksit C të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", i shtuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 672, datë 2.9.2020.
 - 1.3.2 Të autorizohet Kryetari i Bashkisë, për lidhjen e kontratës së qerasë.
 - 1.3.3 Kontrata e qirasë të jetë me afat deri në 10 vjet.
2. Ndarja e sipërfaqjeve sipas destinacionit të përdorimit, do të përcaktohet sipas genplanit bashkëngjitur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.



3. Efektet: Në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e rregullave për rregullimin e qarkullimit dhe parkimeve në qendrat e banuara.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administrata e Bashkisë Pogradec dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuara, Pogradeci Invest.
5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
6. U shpall sot më datë 27.12.2024.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 21 vota

2.Vota Pro 21

3.Vota Kundër 2

4.Vota Abstenim 1

5.Zbardhur më date 27.12.2024